

**FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT**  
**FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT**

[ Data : 25.05.2017]

**Për: Operatorin Ekonomik “Alb Building” shpk**

Procedura e prokurimit: **“Tender i Hapur”** me objekt : **"Rikonstruksioni i rruges Fushe Kruje-Thumane"**.

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **"Rikonstruksioni i rruges Fushe Kruje-Thumane"**.

Kohëzgjatja: brënda 14 muajsh nga data e fillimit te punimeve.

Fondi limit: 741.333.333 (shtatëqind e dyzet e nje milion e treqind e tridhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre) Lekë pa TVSH. Fondi i akorduar per vitin 2017 eshte 208.333.333 leke pa tvsh. Pjesa e mbetur eshte parashikuar per vitin 2018.  
 Burimi i financimit: Buxheti i Shtetit.

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: **Datë 03.03.2017.**

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Nuk ka patur.

Njoftojmë se, kanë qënë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara pa tvsh:

| NR | SHOQERIA                       | OFERTA PA TVSH PARA KONTROLLIT ARITMETIK |
|----|--------------------------------|------------------------------------------|
| 1  | ALB-BUILDING                   | 538,226,327                              |
| 2  | GENER 2                        | 558,892,318                              |
| 3  | Victoria Invest International  | 577,924,211                              |
| 4  | Delta Lavori                   | 582,390,748                              |
| 5  | GJOKA KONSTRUKSION             | 598,601,848                              |
| 6  | "VUTHAJ" SHPK                  | 622,561,200                              |
| 7  | ALB - STAR                     | 625,517,778                              |
| 8  | ALKO-IMPEX General Construcion | 648,807,264                              |
| 9  | ARIFAJ                         | 652,808,814                              |
| 10 | BAMI                           | 704,324,888                              |
| 11 | FUSHA                          | 725,261,351                              |
| 12 | A. N. K.                       | 730,266,630                              |

13 | VARAKU E

NUK KA PARAQITUR OFERTE

Pas vleresimit te dokumentacionit te paraqitur (perfshire rivleresimin) komisioni me unanimitet vendosi:

**1. Te skualifikoje shoqerine “Gener 2” shpk per arsye se:**

Nuk ploteson piken 2.3.1 per kualifikim lidhur me punet e ngjashme, pasi per te provuar realizimin e puneve te ngjashme ka paraqitur dokumentacion per realizimin e objekteve:

- “Rehabilitation of access roads”. Puna eshte realizuar nga shoqeria “Gener 2” shpk dhe “Sicilsaldo” spa. Kjo pune nuk permbush kriteret per tu konsideruar si pune e ngjashme pasi formulari i vleresimit nuk permban vleren e objektit dhe perqindjen e shoqerise “Gener 2” shpk ne realizimin e kesaj pune. Gjithashtu per kete objekt nuk eshte paraqitur asnje fature tatimore.
- “By pass plepa Kavaje, loti 8”. Kontrata eshte lidhur ne daten 01.08.2011 me vlere 874.510.350 leke me tvsh dhe eshte realizuar nga “Gener 2” shpk 50%, “Alb Star” shpk 30% dhe “Gjikuria” shpk 20%. Kolaudimi i objektit eshte bere ne daten 25.11.2015. Vlera e punes se kryer nga shoqeria “Gener 2” shpk ne kete objekt eshte 364.379.312 leke pa tvsh. Shoqeria “Gener 2” shpk duhet te kishte paraqitur dokumentacion per relizimin e nje pune te vetme me vlere jo me pak se 370.666.667 leke. Ne kete menyre kjo shoqeri nuk permbush kerkesen per kualifikim.
- “Rruga e Arbrit”. Kontrata eshte lidhur ne daten 06.05.2011 me vlere 2.332.963.024 leke me tvsh dhe eshte realizuar nga “Gener 2”, me afat 20 muaj. Kolaudimi i objektit eshte bere ne daten 05.08.2013. Objekti eshte jashte afatit 3 vjecar dhe ne kete menyre nuk permbush kerkesen per kualifikim.

Nuk ploteson piken 2.3.1 per kualifikim lidhur me punesimin e mjekut te shoqerise, pasi nuk ka paraqitur asnje dokumentacion per kete qellim.

Duke qene se keto te meta jane thelbësore, komisioni vendosi te mos vazhdoje me me shqyrtimin e dokumentacionit te mbetur per kete shoqeri.

**2. Te skualifikoje bashkimin e perkohshem te shoqerive “Viktoria Invest International” shpk (45.59%), “Victoria Invest” shpk (40.2%) dhe “Al-Asfalt” shpk (14.21%) per arsye se:**

Shoqeria “Viktoria Invest International” shpk nuk ploteson piken 2.2.4 te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim lidhur me taksat vendore pasi, referuar puneve ne proces te deklaruar, kryen aktivitet ne Tirane nga viti 2015 e ne vazhdim dhe nuk ka paraqitur dokumentacion per shlyerjen e detyrimeve vendore.

Shoqeria “Viktoria Invest” shpk nuk ploteson piken 2.2.4 te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim lidhur me taksat vendore pasi, referuar puneve ne proces te deklaruar, nga viti 2016 ushtron aktivitet ne Librazhd (ne objektin “Rikualifikim urban, zona ne hyrjen perendimore te qytetit Librazhd dhe mbrojtje lumore”, me vlere 82.200.510 leke) dhe ne Bilisht (ne objektin “Rikualifikim urban i qendres se qytetit Bilisht, loti i”, me vlere 102.536.108 leke. Per keto dy objekte nuk ka paguar detyrimet vendore dhe nuk i ka regjistruar ne QKB.

Shoqeria “Viktoria Invest International” shpk nuk ploteson piken 2.3.1 te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim lidhur me punet e ngjashme pasi per te vertetuar plotesimin e kriterit ka paraqitur dokumentacion per realizimin e puneve:

“Sistemim asfaltim rruga Librazhd - Qafe Stude loti 3”. Per kete pune kontrata eshte lidhur ne daten 06.05.2011 dhe puna eshte perfunduar ne daten 30.09.2015. Vlera e plote me tvsh e kesaj pune eshte 2.270.873.995 leke.

“Rikonstruksion i rruges Grekan – Deshiran – Vlashuk (Kozare)”. Per kete pune kontrata eshte lidhur ne daten 27.12.2012 dhe puna eshte perfunduar ne daten 20.11.2014. Vlera e plote me tvsh e kesaj pune eshte 454.641.388 leke.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur per objektin “Sistemim asfaltim rruga Librazhd - Qafe Stude loti 3”, rezulton se ankimuesi ka paraqitur, krahas kontratave dhe dokumentacionit tjetër shoqërues, edhe faturat tatimore të shitjes të cilat i përkasin viteve 2011 deri 2015, Komisioni konsideron si pune te kryer brenda tre viteve te fundit ate pjese te punes qe eshte realizuara pas dates 06.03.2014 (pasi tenderi qe shqyrtohet eshte hapur ne daten 06.03.2017). Referuar faturave tatimore vlera e punes se kryer gjate tre viteve te fundit per kete objekt eshte 139.915.701 leke pa tvsh.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur per objektin “Rikonstruksion i rruges Grekan – Deshiran – Vlashuk (Kozare)”, rezulton se ankimuesi ka paraqitur, krahas kontratave dhe dokumentacionit tjetër shoqërues, edhe faturat tatimore të shitjes të cilat i përkasin viteve 2013 deri 2015, Komisioni konsideron si pune te kryer brenda tre viteve te fundit ate pjese te punes qe eshte realizuara pas dates 06.03.2014 (pasi tenderi qe shqyrtohet eshte hapur ne daten 06.03.2017). Referuar faturave tatimore vlera e punes se kryer gjate tre viteve te fundit per kete objekt eshte 160.818.672 leke pa tvsh.

Duke qene se shoqeria “Viktoria Invest International” shpk eshte shoqeria qe do te kryeje perqindjen me te madhe te punes (45.59%), duhet te paraqiste dokumentacion per realizimin brenda tre viteve te fundit te punimeve me vlere jo me pak se 370.666.667 leke pa tvsh te realizuara ne nje objekt te vetem ose per realizimin brenda tre viteve te fundit te punimeve me vlere jo me pak se 675.947.733 leke pa tvsh te realizuar ne shume objekte. Kjo shoqeri nuk realizon asnje prej kushteve te mesiperm dhe ne kete menyre nuk ploteson kete kerkese per kaulifikim.

**3. Te skualifikoje bashkimin e perkohshem te shoqerive “Delta Lavori” (44.55%), “Company Riviera 2008” shpk (25.05%), “Agri Konstruksion” shpk (21.55%) dhe “Ndrekaj” shpk (8.85%) per arsye se:**

Referuar deklarates se puneve ne proces rezulton se shoqeria “Company Riviera 2008” shpk ka ne proces pune me nje vlere te pergjithshme prej 229.425.750 leke pa tvsh. Keto pune konsistojne ne rivitalizime urbane dhe rikonstruksione rruges. Sipas marreveshjes se bashkepunimit shoqerise “Company Riviera 2008” shpk i takon te kryeje nje volum punimesh prej 145.888.882 lekesh pa tvsh. Vlera totale e punimeve qe duhet te kryeje shoqeria “Company Riviera 2008” shpk nese shpallet fituese e kontrates qe shqyrtohet eshte 375.314.632 leke, nderkohe qe kjo shoqeri zoteron piken e licenses NP-4C e cila i lejon te kryeje ne te njejten kohe punime me vlere te pergjithshme jo me shume se 100.000.000 leke. Bazuar ne Vendimin e Keshillit te Ministrave nr 42, date 16.01.2008, Kreu III, pika 1, paragrafi IIb kjo shoqeri duhet te skualifikohet.

Dokumentat e paraqitur nga shoqeria “Delta Lavori” nuk jane te apostiluara ne perputhje me ligjin. Shoqeria “Delta Lavori” nuk ploteson piken 2.3.1 per kualifikim lidhur me punet e ngjashme, pasi nuk ka paraqitur formularin e vleresimit sipas shtojces 8.

Shoqeria “Delta Lavori” nuk ploteson kriterin 2.3.5 per kualifikim pasi nuk ka paraqitur kontraten e punes me mjekun.

Duke qene se kjo e mete eshte thelbesore, komisioni vendosi te mos vazhdoje me me shqyrtimin e dokumentacionit te mbetur per kete bashkim shoqerish.

**4. Te skualifikoje shoqerine “Gjoka Konstruksion” shpk per arsye se:**

Nuk ploteson piken 2.2.4 te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim lidhur me taksat vendore pasi, referuar puneve ne proces te deklaruar, kryen aktivitet ne Bushat nga viti 2016 e ne vazhdim dhe nuk ka paraqitur dokumentacion per shlyerjen e detyrimeve vendore.

**5. Te skualifikoje bashkimin e perkohshem te shoqerive “Vuthaj” shpk (37%), “4A-M” shpk (39%) dhe “PE VLA KU” shpk (24%) per arsye se:**

Shoqeria “4A-M” shpk e cila ka edhe perqindjen me te madhe ne bashkimin e shoqerive nuk ploteson piken 2.2.4 te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim lidhur me taksat vendore pasi, referuar puneve ne proces te deklaruar, kryen aktivitet ne Finiq, Lezhe dhe Roskovec Fier nga viti 2016 e ne vazhdim dhe nuk ka paraqitur dokumentacion per shlyerjen e detyrimeve vendore.

Shoqeria “4A-M” shpk e cila ka edhe perqindjen me te madhe ne bashkimin e shoqerive nuk ploteson piken 2.3.1 per kualifikim lidhur me punet e ngjashme, pasi per te provuar realizimin e puneve te ngjashme ka paraqitur dokumentacion per realizimin e objektit “Ndertim rruga unaza e re e Tiranes...”. Me kete pune nuk ploteson kriterin per kualifikim pasi “4A-M” shpk, si kompania e bashkimit me perqindjen me te madhe, duhet te paraqiste dokumentacion per realizimin e nje pune te vetme me vlere jo me pak se 370.666.666 leke nderkohe qe vlere pa tvsh e punes se deklaruar eshte 145.454.281 leke duke mos e plotesuar kushtin.

Shoqeria “4A-M” shpk e cila ka edhe perqindjen me te madhe ne bashkimin e shoqerive nuk ploteson piken 2.3.3 per kualifikim lidhur me stafin pasi nuk ka paraqitur dokumentacion per ing ndertimi me profil transport dhe ing topograf, te domosdoshem per kryerjen e punimeve te shtresave rrugore qe kjo kompani ka marre persiper, referuar marreveshjes se bashkepunimit.

Shoqeria “4A-M” shpk e cila ka edhe perqindjen me te madhe ne bashkimin e shoqerive nuk ploteson piken 2.3.7 per kualifikim lidhur me mjetet pasi ka paraqitur dokumentacion vetem per kamiona, autobot, kamioncine, kamion me vinc, ekskavator me goma dhe ekskavator me zinxhire nderkohe qe ka marre persiper punime shtresash dhe nuk disponon asnje mjet per shtresat rrugore.

**6. Te skualifikoje shoqerine “Alb Star” shpk per arsye se:**

Nuk ploteson piken 2.3.1 per kualifikim lidhur me punet e ngjashme, pasi per te provuar realizimin e puneve te ngjashme ka paraqitur dokumentacion per realizimin e objektit “Rikonstruksioni i rruges lidhese midis nje grupi fshatrash...”. Me kete pune nuk ploteson kriterin per kualifikim pasi duhet te paraqiste dokumentacion per realizimin e nje pune te vetme me vlere jo me pak se 370.666.666 leke nderkohe qe vlere pa tvsh e punes se deklaruar eshte 347.416.505 leke duke mos e plotesuar kushtin.

**7. Te skualifikoje shoqerine “Alko Impex General Construcion” shpk per arsye se:**

Shoqeria “Alko Impex” shpk nuk ploteson piken 2.2.4 te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim lidhur me taksat vendore pasi, referuar puneve ne proces te deklaruar, kryen aktivitet ne Librazhd, Devoll, Koplik dhe Kavaje nga viti 2015 e ne vazhdim dhe nuk ka paraqitur dokumentacion per shlyerjen e detyrimeve vendore.

Shoqeria “Alko Impex” shpk nuk ploteson piken 2.3.3 per kualifikim lidhur me stafin e nevojshem pasi nuk ka paraqitur dokumentacion per nje inxhinier mjedisi, sic kerkohet ne dokumentet e tenderit.

Duke qene se keto te meta jane thelbesore, komisioni vendosi te mos vazhdoje me me shqyrtimin e dokumentacionit te mbetur per kete shoqeri.

**8. Te skualifikoje bashkimin e perkohshem te shoqerive “Arifaj” shpk (47%), “NTP Eurokos” shpk (48%) dhe “Denisi 05” shpk (5%) per arsye se:**

Shoqeria “NTP Eurokos” shpk nuk ploteson piken 2.2.4 te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim lidhur me taksat vendore pasi, referuar puneve ne proces te deklaruar, kryen aktivitet ne Vlore dhe Elbasan - Librazhd nga viti 2016 e ne vazhdim dhe nuk ka paraqitur dokumentacion per shlyerjen e detyrimeve vendore.

Shoqeria “NTP Eurokos” shpk nuk ploteson piken 2.3.3 per kualifikim lidhur me stafin e nevojshem pasi nuk ka paraqitur dokumentacion per nje inxhinier ndertimi me profil transport, sic kerkohet ne dokumentet e tenderit, nderkohe qe ka marre persiper te kryeje punime rrugore ne te cilat ky specialitet e shte i domosdoshem.

Duke qene se keto te meta jane thelbesore, komisioni vendosi te mos vazhdoje me me shqyrtimin e dokumentacionit te mbetur per kete bashkim shoqerish.

**9. Te skualifikoje shoqerine “ANK” shpk per arsye se:**

Nuk ploteson piken 2.3.7 per kualifikim lidhur me mjetet pasi nuk ka paraqitur asnje informacion.

Duke qene se kjo e mete eshte thelbesore, komisioni vendosi te mos vazhdoje me me shqyrtimin e dokumentacionit te mbetur per kete shoqeri.

**10. Te skualifikoje shoqerine “Fusha” shpk per arsye se:**

Nuk ploteson piken 2.3.1 per kualifikim lidhur me punet e ngjashme, pasi per te provuar realizimin e puneve te ngjashme ka paraqitur dokumentacion per realizimin e objektit “Ndertim rruga Unaza e re Tirane”. Me kete pune nuk ploteson kriterin per kualifikim pasi duhet te paraqiste dokumentacion per realizimin e nje pune te vetme me vlere jo me pak se 370.666.666 leke nderkohe qe vlere pa tvsh e punes se deklaruar eshte 66.431.531 leke duke mos e plotesuar kushtin.

**11. Te skualifikoje shoqerine “Varaku E” shpk e cila nuk ka paraqitur oferte.**

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Operatorin ekonomik “Alb Building” shpk se oferta e paraqitur, me vlerë 538.226.327 (peseqind e tridhjetë e tete milion e dyqind e njezet e gjashtë mijë e treqind e njezet e shtate) lekë pa TVSH është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë **Autoritetit Kontraktor:**

- **Fondi Shqiptar i Zhvillimit**
- **Rr. “Sami Frashëri”, Nr. 10, Tirana, Albania**
- **Phone: 00355 4 2 235 597/8 (int.151)**
- **Fax: 00355 4 2 234 885**

sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda pese ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë **20.03.2017**.

Ne datën 29.03.2017 paraqiti ankese për vleresimin shoqëria "Victoria Invest International" shpk. Ankeses ju kthye përgjigje në datën 04.04.2017.

Ne datën 30.03.2017 paraqiti ankese për vleresimin shoqëria "Bami" shpk. Ankeses ju kthye përgjigje në datën 05.04.2017.

Ne datën 31.03.2017 paraqiti ankese për vleresimin shoqëria "Gener 2" shpk. Ankeses ju kthye përgjigje në datën 05.04.2017.

Ne datën 06.04.2017 doli urdhri i brendshëm për zbatimin e vendimit të Komisionit të shqyrtimit të ankesave.

Ne datën 06.04.2017 Komisioni i Vleresimit të Ofertave u mbledh dhe mbajti procesverbalin për rivleresimin.

Ne datën 14.04.2017 shoqëria "Bami" shpk paraqiti ankese pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

Ne datën 25.05.2017 u botua në faqen e Komisionit të Prokurimit Publik vendimi përkatës i cili le në fuqi vendimin e autoritetit kontraktor.